



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.53, datë 08.08. 2018

PËR

**“SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE “ELCOM SH.P.K”, KUNDËR MASËS
ADMINISTRATIVE TË DËNIMIT ME GJOBË”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj Sara Rec, në mbledhjen e datës 03.08.2018, në mbështetje të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen objekt:

**“SHQYRTIMI I ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE “ELCOM SH.P.K”, KUNDËR MASËS
ADMINISTRATIVE TË DËNIMIT ME GJOBË”.**

BAZA LIGJORE:

1. Neni 132 e vijues të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Neni 46 i ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë (**ligji nr.10433/2011**);
3. Neni 128 e vijues të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
4. Rregullore Nr.46 datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendimin Nr.2695, datë 27.10.2016 të Këshillit Drejtues;
5. Rregullore Nr.12 dt. 07.04.2010, “Për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve, Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”;
6. Rregullore e Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankesa e sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike “Elcom Sh.p.k”, me shkresën e datës 03.07.2018, protokolluar në AKEP me nr. Prot. 1755/4, datë 04.07.2018;
2. Projekt – Aktin “Mbi shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Elcom sh.p.k”, lidhur me Gjobën nr.82, datë 29.06.2018 të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit nr.132, datë 29.06.2018.
3. Autorizimin e Inspektimit, me shkresën me nr. 1755, datë 11.06.2018;
4. Procesverbalin e Inspektimit nr.195, date 25.06.2018, shkresë me nr. Prot. 1755/2, datë 02.07.2018;
5. Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, shkresë nr. Prot. 1759/3, datë 02.07.2018 dhe gjobën me nr.82, datë 29.06.2018;
6. Relacion shpjegues (Relacioni);

dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Në aspektin formal:

1. Ankimi i sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike “Elcom sh.p.k”, i datës 03.07.2018, mbi gjobën e vendosur nga inspektorët e AKEP, është brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe plotëson kushtet për praninë të ankimit të parashikuara në nenin 135 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015).

2. Me Autorizimin e Inspektimit nr.1755, datë 11.06.2018, Kryetari i Këshillit Drejtues ka udhëruar kryerjen e inspektimit në sipërmarrësin e komunikimeve elektronike “Elcom sh.p.k”, për periudhën 25.06.2018 – 29.06.2018, me objekt:

Përshkrim i objektit të inspektimit është verifikimi i zbatimit të:

i) Kushteve të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm lidhur me:

- Bashkëveprimin e shërbimeve dhe interkoneksionin e rrjeteve;
- Sigurimin e disponueshmërisë dhe përdorimin e numrave nga plani i numeracionit për përdoruesit fundorë;
- Mbrojtjen e të dhënave vetjake dhe të privatësisë;
- Mbrojtjen e përdoruesve;
- Respektimin e rasteve të kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme;
- Lejimin e përgjimit nga autoritetet kompetente;
- Ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në rastet e gjendjes së emergjencës;
- Detyrimin për të ofruar akses;
- Mbrojtjen e rrjeteve të komunikimeve publike ndaj aksesit të paautorizuar;
- Detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjetve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të shërbimeve e faciliteteve shoqëruese;
- Regjistrimin e pajtimtarëve, ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për qëllime të ndjekjes penale, etj.

ii) Kushteve të përcaktuara në Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave;

iii) Kushteve të përcaktuara në aktet normative të AKEP lidhur me:

- Publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve;
- Kushteve të përgjithshme të kontratave tip për pajtimtarin.

Në zbatim të Autorizimit të Inspektimit të lartpërmendur, grupi i inspektimit ka njoftuar me anë të postës elektronike në datën 12/06/2018 ora 11:48, përfaqësuesin ligjor të shoqërisë “Elcom sh.p.k”, z. Enio Karance, duke i dërguar edhe kopje të autorizimit të inspektimit nr.1755, datë 11.06.2018. Gjithashtu, përfaqësuesit i është kërkuar krijimi i kushteve për kryerjen e inspektimit, në përputhje me Rregulloren nr.46, date 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbime të Komunikimeve Elektronike”. (këtu e më poshtë: *rregullore e inspektimit*).

3. Inspektorët kanë konstatuar se:

- Sipërmarrësi “Elcom sh.p.k”, sipas Autorizimit dhënë nga AKEP, është regjistruar për të ofruar:

Rrjete publike të komunikimeve elektronike:

Rrjete publike tokësore fikse:

a) Rrjeti i aksesit:

- Me përcjellësa metalikë.

b) Rrjeti i transmetimit:

- Me përcjellësa metalikë.

Shërbime publike të komunikimeve elektronike:

Shërbime telefonike:

a) Shërbime telefonike të ofruara me anë të rrjeteve publike fikse:

- Zë (thirrje fibre, thirrje kombëtare, thirrje ndërkombëtare).

b) Shërbime të tjera:

- Faks;

- Posta zanore;

- Kujdesi për klientin;

- Numeratori telefonik.

Nga ky sipërmarrës theksojmë se, nuk ka patur asnjë përgjigje apo interesim, në lidhje me këtë kërkesë të AKEP, për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në ligj dhe Rregullores nr. 12 datë 07.04.2010 “Për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve, Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”.

4. Në përfundim, Grupi i inspektimit, pas verifikimit, ka konstatuar se: Përfundimisht, bazuar në faktet e konstatuara dhe shpjegimet, parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin 137/VII, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Rregullores Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.2695, datë 27.10.2016, arrihet në përfundimin se:

Sipërmarrësi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike “Elcom Shpk” ka vepruar në shkelje të nenit 16 pika ç, të Ligjit nr.9918/2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenit 5, pika a) të Rregullores Nr.12, Datë 07.04.2010 “Për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” e ndryshuar, e cila në kuptim të neni 135 “Kundravajtjet administrative” të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përbën kundravajtje administrative.

Për këtë shkelje të kryer nga sipërmarrësi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike “Elcom sh.p.k”, Grupi i inspektimit, bazuar në nenin 137/VII, të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i

ndryshuar, ka marrë vendim për dhënien e masës administrative “Gjobë” në vlerën **100.000 (njëqindmijë) lekë.**

Grupi i inspektimit, për rregullimin e shkeljes së konstatuar, i la detyrë sipërmarrësit “Elcom Shpk” të vendosë në ambjentet e tij regjistrin e shkeljeve ose incidenteve të sigurisë ku të specifikohet shkelja, kategorizimi i saj, shkaku, pasoja, masat e ndërmarra etj, sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 6 të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi Masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” në AKEP.

Sipërmarrësi “Elcom Shpk” të vendosë në ambjentet e tij Planin e Trajtimit ose reagimit ndaj incidenteve të sigurisë dhe Plani i Vazhimit të Biznesit në rastet e situatave të jashtëzakonshme apo katastrofave sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 6 të Rregullores Nr.37 datë 29.10.2015 “Mbi Masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” në AKEP.

Të kryeje raportimin e treguesve të cilësisë për 6 mujorin e dytë të vitit 2018 si dhe raportimet statistikore për 3 mujorin e parë të vitit 2018 në modulën e raportimeve të AKEP.

Korrigjimi i problematikave të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre brenda datës 16.07.2018.

Sipërmarrësi “Elcom shpk” duhet të njoftojë për korrigjimin e këtyre problematikave brenda afatit të përcaktuar dhe të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.

Në aspektin e trajtimit në thelb të çështjes:

AKEP, pasi shqyrtoi materialet pjesë përbërëse të dosjet së inspektimit, konstatimet dhe konkluzionet e arritura në përfundim të procesit të inspektimit, vlerëson se:

- i. Grupi i inspektimit në zbatim dhe konform me parashikimet e Rregullores nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, ka kryer veprimet proceduriale duke zhvilluar procedurë inspektuese.
- ii. Rezulton se, Grupi i inspektimit ka njoftuar paraprakisht përfaqësuesin e sipërmarrësit “Elcom sh.p.k”, me postë elektronike në datën 12/06/2018 ora 11:48, duke i dërguar bashkëngjitur kopjen e Urdhrit të Inspektimit nr.1755, datë 11.06.2018.
- iii. Sa i takon shkeljeve të konstatuara nga inspektorët gjatë verifikimit, vërehet se, sipërmarrësi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike “Elcom sh.p.k”, edhe pse është njoftuar disa herë nga strukturat e posaçme të AKEP të ngarkuara për zbatimin e detyrimeve rregullatore, nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga Rregullorja Nr.12 dt. 07.04.2010, “Për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve, Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”.

- iv. Mospërbushja nga sipërmarrësi “Elcom Sh.p.k”, e detyrimeve të rregullores nr. 12 dt. 07.04.2010, “Për të Dhënat Statistike dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve, Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, përbën gjithashtu, shkelje të parashikimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e konkretisht nenit 16, që përcakton: detyrimin e sipërmarrësve të rrjeteve dhe / ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për të dhënë informacion.
- v. Në njoftimet e kryera nga strukturat përgjegjëse të AKEP, rezulton se sipërmarrësit “Elcom Sh.p.k”, i është lënë afat për përbushjen e detyrimeve, për të raportuar mbi të Dhënat Statistike dhe Financiare Periodike. Në lidhje me njoftimet e AKEP mbi këtë raportim, nga ky sipërmarrës nuk ka patur interesime apo përgjigje.
- vi. Nga informacioni i marrë nga drejtoria e DMKI rezulton se, Elcom Sh.p.k, në inspektimin e kryer më datë 23.06.2016, është gjetur në shkelje të nenit 122 të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, që përcakton: detyrimin e sipërmarrësve të rrjeteve dhe / ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për të zbatuar masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurime e rrjeteve dhe / ose shërbimeve të ofruara prej tyre. Për këtë shkelje ndaj sipërmarrësit është marrë masa administrative Gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) Lekë. Kjo gjobë rezulton e paguar pjesërisht në vlerën 20.000 (njëzetëmijë) lekë pra është debitor në AKEP.
- vii. Sipërmarrësi “Elcom sh.p.k” është njoftuar nga Këshilli Drejtues, me shkresën e datës 29.07.2018 “Për thirrjen në seancë dëgjimore”, në përputhje me nenin 135, pika 4, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim që ky sipërmarrës të kishte mundësinë për të dhënë shpjegime, përpara marrjes së vendimit nga Këshilli Drejtues.
- viii. Më datë 31.07.2018, ora 11:00, në ambientet e AKEP, u zhvillua takimi, në përputhje me afatin e përcaktuar për seancën dëgjimore. Në këtë takim, nga AKEP ishin të pranishëm: Anëtarët e Këshillit Drejtues të AKEP, Grupi i Punës i ngarkuar me trajtimin e çështjes si dhe përfaqësuesit e grupit të inspektimit. Nga ana e sipërmarrësit “Elcom sh.p.k” u paraqit përfaqësuesi i shoqërisë së “Elcom sh.p.k”, z.Enio Karance.
- ix. Sipërmarrësi “Elcom sh.p.k” nuk paraqiti ndonjë dokument plotësues për të vërtetuar se gjoba është vendosur në mënyrë të padrejtë dhe duke qënë së është në shkelje të nenit 16 pika ç, të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e të rregullores nr. 12 dt. 07.04.2010, “Për të Dhënat Statistike dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve, Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, i kërkoi KD minimizimin e masës administrative me gjobë për sipërmarrësin e komunikimeve elektronike “Elcom sh.p.k”.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe në pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, dhe në zbatim nenit 130 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të rrëzojë ankimin e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Elcom Sh.p.k”;
2. Të ndryshojë masën administrative të propozuar nga grupi i Inspektimit, duke vendosur gjobë në vlerën 10.000 lekë;
3. Ngarkohet grupi i Inspektimit dhe struktura përkatëse e AKEP të ndjeki lëshimin dhe ekzekutimin e gjobës;
4. Të njoftohet sipërmarrësi Elcom Sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatë, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi;
6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.
Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Ilir Zela

ANËTARË:

1. **Alban Karapici**
2. **Edlira Dvorani**
3. **Ketrin Topçiu**
4. **Klarina Allushi**